

VENDIM
Nr. 351, datë 29.4.2015

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË
TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, dhe 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutës së Këshillit të Sigurimit (“Lista e OKB-së”), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar, bëhen shtesat, si më poshtë vijon:

1. Në listën e shkronjës “A”, “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me Talibanët”, të regjistrohen individët e renditur në shkronjën “a”, të listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues për Talibanët.

2. Në listën e shkronjës “B”, “Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me Talibanët”, të regjistrohen individët e renditur në shkronjën “b”, të listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues për Talibanët.

3. Në listën e shkronjës “C”, “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën “Al-Qaida”, të regjistrohen individët e renditur në shkronjën “c”, të listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues për organizatën “Al-Qaida”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

AZHURNIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË
TERRORIZMIT

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT (“LISTA E OKB-së”)

A. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME TALIBANËT

a) Lista e shtuar në “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me Talibanët”;

1. ABDUL BASIR; NOORZAI.

B. LISTA E KOMPANIVE QË I TAKOJNË OSE BASHKËPUNOJNË ME TALIBANËT

b) Lista e shtuar në “Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me Talibanët”;

1. HAJI BASIR AND ZARJMIL COMPANY HAWALA.

C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATËN AL-QAIDA

c) Lista e shtuar në “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”;

1. ALI; BEN TAHER; BEN FALEH; OUNI HARZI,

2. TARAK; BEN TAHER; BEN FALEH; OUNI HARZI.

Shënim. Gjeneralitetet e tjera për personat, emrat e të cilave janë radhitur më sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.